



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:039188

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004086

KPPP.nr.262/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A, me NRB: 70325399, me seli në Prishtinë, rruga “Nëna Terezë” nr.36, kundër debitorit Voqar, me seli në Prishtinë, Çagllavicë, duke vendosur lidhur me prapësimin personit të tretë V.R., përfaqësuar sipas autorizimit nga B.R., me vendbanim në Viti, rruga “Lidhja e Prizrenit” nr.50, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1439/18 të datës 18.12.2018, të Përmbartuesit Privat Ilir Z. Mulhaxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i V.R., dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.1439/18 i datës 18.12.2018, i Përmbartuesit Privat Ilir Z. Mulhaxha, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.1439/18 të datës 18.12.2018, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist DPR - ... të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’ia paguajë kreditorit shumën prej 7,721.95 €, për periudhën kohore nga data 17.08.2004 deri më datë 20.03.2013, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm. Nëse debitori brenda afatit nuk e përmbush detyrimin, përmbartimi të realizohet përmes ndalimit të mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogarinë rrjedhëse, ose përmes regjistrimit, vlerësimit,

sekuestrimit dhe shitjes së sendeve të luajshme të debitorit të cilat ndodhen në posedim të tij deri në vlerën e borxhit.

V.R., përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor duke theksuar se me datë 16.09.2013, në procedurën e likuidimit ka blerë nga AKP-ja pasurinë – lokalin e Voqar-it, andaj borxhi i kërkuar nuk është borxh i personit të tretë. Tutje ka shtuar se ndërmarrja shoqërore “Voqar” nuk ekziston e njëjta është privatizuar nga AKP, e njëjta ka administruar me pasurinë e shoqërisë deri në shitjen e këtij lokali me datë 16.09.2013, pas kësaj date personi i tretë ka filluar ta shfrytëzoj lokalin, ashtu që borxhi i kërkuar nuk është borxh i personit të tretë. Sa i përket dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor përkatësisht “Transaksionet e Konsumatorit” nuk mund të llogaritet si dokument i besueshëm për përmbarrim, sepse i njëjti nuk është dokument i besueshëm sipas nenit 29 të LPP-së, po ashtu shuma e kërkuar nuk është e saktë ashtu që shuma për periudhën e kërkuar sipas propozimit do të duhet të ishte 4,645.34 €. Ka shtuar se kreditori propozimin për përmbarrim e ka paraqitur me datë 18.12.2018, për konsumin e energjisë elektrike të krijuar nga data 17.08.2004 deri me 20.03.2013, ashtu që kërkesa e kreditorit është e parashkruar sipas dispozitave të nenit 355 të LMD-së. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa propozimin e debitorit ta refuzoj për shkak të arritjes së parashkrimit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të paargumentuar me asnjë provë. Ka theksuar se sa i përket pretendimit të debitorit se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor nuk paraqet dokument të besueshëm, nuk qëndron një pretendim i tillë pasi që dokumenti i plotëson të gjitha kushtet sipas LPP-së. Tutje ka shtuar se poseduesi faktik Jeton Rexhepi, ka nënshkruar kontratë për pagesën e borxhit me nr.46006 të datës 01.09.2016, me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve, i njëjti nuk ka bërë pagesat sipas kontratës andaj borxhi i është kthyer. Sa i përket pretendimeve të personit të tretë se borxhi është parashkruar ka deklaruar se të njëjtat nuk qëndrojnë, pasi që debitori ka bërë ndërprerjen e parashkrimit me rastin e nënshkrimit të kontratës mbi pagesën e borxhit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar, ndërsa urdhrin përmbarrimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat

e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi është i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit. 2. Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.”*

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se urdhri mbi lejimin e përmbartimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1, ngase në propozim për përmbartim kreditori nuk i ka treguar të dhëna e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, përkatësisht propozimi për përmbartim është ushtruar ndaj Voqar, me adresë në Çagllavicë, me numër personal 1012963792, duke mos treguar të dhënat e tjera të debitorit, ndërsa në kontratën për pagesën e borxhit tek emri i konsumatorit figuron Voqar, ndërsa tek i poseduesit faktit figuron J.R.. Në vlerësimin e gjykatës, vetëm përshkrimi i debitorit Voqar, pa treguar numrin e biznesit apo identifikues të debitorit, nuk është i mjaftueshëm për identifikimin e saktë të debitorit. Po ashtu, referuar përmbajtjes së propozimit për përmbartim, nuk është treguar nëse propozimi është paraqitur ndaj dy debitorëve dhe atë Voqar si person juridik dhe J.R. si person fizik, dhe nëse është kërkuar përmbushja në mënyrë solidare prej tyre, apo nëse propozimi është paraqitur vetëm ndaj debitorit Voqar apo vetëm ndaj poseduesit faktit J.R.. Andaj, si rezultat i këtyre të metave, propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet nga neni 38 i LPP-së.

Me dispozitën e nenit 43, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar*

kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.

Bazuar në dispozitën e lartcekur, gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarrimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozim për përmbarrim nuk janë paraqitur të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit, dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarrim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat tani nuk mund të evitohen, ngase gjykata në fazën e procedurës sipas mjetit juridik, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim, ndërsa organi përmbarrues - Përmbarruesi Privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbarrimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në kuptim të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.262/24 datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.